



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 25 mars 2021
Nr.ref.:RK 1734/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI59/20

Parashtrues

Ramadan Sopaj

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme,
Pml.nr.319/2019, të 10 dhjetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ramadan Sopaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Janqishtë, komuna e Malishevës, i cili përfaqësohet nga Reshat Millaku, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml.nr.319/2019 të 10 dhjetorit 2019, pranuar më 27 dhjetor 2019, në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.235/2019 të 19 qershorit 2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.294/2019 të 17 janarit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve të kontestuara përmes së cilave parashtruesi i kërkesës pretendon t'i jenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi po ashtu kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) *"...të shtyjë ekzekutimin e dënimit me burg..., sepse në këtë mënyrë do të evitohet një dem i pariparueshëm, për të gjykuarin, për shkak se në veprimet e tij nuk manifestohen elementet e veprës penale"*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masa e Përkohshme], dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

6. Më 14 prill 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anetarë).
8. Më 28 maj 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme, në pajtim me Ligjin.
9. Më 21 shtator 2020, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës të dorëzonte si dëshmi autorizimin e nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës për përfaqësimin në Gjykatë.

10. Më 29 shtator 2020, përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi në Gjykate autorizimin e vlefshëm, i cili është nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës.
11. Më 3 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 8 korrik 2015, Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzën PP.II.nr.1149/2014, ndaj parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit se i njëjti duke ushtruar profesionin e mjekut të mjekësisë familjare, kishte kryer veprat penale nga neni 232, paragrafi 3, pika 3.10, në lidhje me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK), ndaj të miturave A.H dhe F.G.
13. Më 3 prill 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit PM.nr.123/2015, parashtruesin e kërkesës e shpall fajtor dhe e dënon me burgim efektiv, në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj, duke ia llogaritur kohen e kaluar në paraburgim, prej 30 tetorit 2014, deri me 30 nëntor 2014 dhe kohen e kaluar në arrest shtëpiak prej 30 nëntorit 2014, deri me 30 maj 2014. Vendimmarrja e gjykatës ishte mbështetur në dëshmitë e të dëmtuarve, në raportin e ekspertit, raportin e psikologut të shkollës “Qendra e Kompetencës” në Malishevë dhe pjesërisht në dëshmitë e dëshmitareve A.B., V.H, B.G. dhe N.Z.
14. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës, ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 3 prillit 2017, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të ligjit penal dhe procedural dhe vendimit në lidhje me dënimin. Kundër Aktgjykimit në fjalë, ankesë kishte ushtruar gjithashtu Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe mbrojtësit e të dëmtuarve A.H dhe F.G., të cilët kërkuan dënim më të ashpër për parashtruesin e kërkesës.
15. Më 11 tetor 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit PAKR.nr.379/2017, anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 3 prillit 2017, duke e kthyer çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar dashjen e kryerjes së veprës penale dhe faktin nëse ndërmarrja e veprimeve të mjekut ishte në kuadër të profesionit dhe përgjegjësi të tij si specialist i mjekësisë familjare, duke kërkuar që gjykata për këtë çështje në procedurë të rigjykimit të angazhojë ekspert të fushës. Kjo gjykatë mes tjerash arsyetoi: *“Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, pasi që ta pranon lëndën, duhet që ta cakton shqyrtimin gjyqësor, dhe ti thërret të gjitha palët nga shkresat e lëndës, të plotësojë anën formalo-juridike, me rastin e dëgjimit të dëmtuarave të mitura, të sigurojë kushte sa më të mira për punë, ambient me relaksues që të miturat të kenë mundësinë e dhënies së deklaratave pa ndonjë ngarkesë eventuale, të sigurojë ekspertet përkatës sikurse është, gjinekologu, psikologu, të procedojë me provat e tera, varësisht gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor dhe me pastaj të shfrytëzojë edhe provat materiale nga shkesat e lëndës, për të nxjerrë aktgjykim i cili do të jetë i pranueshëm për të gjitha palët në procedurë”*.

16. Më 17 janar 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për të mitur, përmes Aktgjykimit PM.nr.294/2017, parashtresin e kërkesës e shpall serish fajtorë për të njëjtat vepra penale dhe e dënon serish me burg efektiv në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet, e 6 (gjashtë) muaj, duke iu llogaritur koha e kaluar në paraburgim, prej 30 tetorit 2014, deri me 30 nëntor 2014 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, prej 30 nëntorit 2014, deri më 30 maj 2015. Tutje arsyetimi i gjykatës: *“Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave të administruara ka përfunduar se në veprimet e të akuzuarit Ramadan Sopaj formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprave penale Sulm Seksual nga neni 232, par. 3, pika 3.10, lidhur me par. 1, të KPRK,, për të cilat vepra penale i akuzuari ka qenë i vetëdijesohem për veprimet e tija...Nga provat e cekura më lartë e të cilat janë administruar dhe kundërshtuar në seancat e shqyrtimit gjyqësor nga palët ndërgjyqëse. Gjykata vlerëson se është provuar jashtë çdo dyshimit se i akuzuari veprat penale për të cilat është akuzuar i ka kryer me dashje direkte duke qenë në dijeni se të dëmtuarat janë të mitur”.*
17. Parashtruesi i kërkesës, brenda afateve ligjore, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.294/2017 të 17 janarit 2019, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit penal dhe procedural, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit në lidhje me dënimin. Kundër Aktgjykimit në fjalë, ankesë ushtroan mbrojtësit e të dëmtuarave A.H dhe F.G, duke kërkuar dënim me të ashpër për parashtruesin e kërkesës.
18. Më 20 maj 2019, Prokuroria e Apelit në Prishtinë, përmes parashtresës PPA/I.nr.225/2019, i propozoi Gjykatës së Apelit që të aprovohen ankesat e të dëmtuarave A.H. dhe F.G. dhe që parashtruesit të kërkesës t'i shqiptohet një dënim më i lartë.
19. Më 19 qershor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR.nr.235/2019, refuzoi, si të pabazuara, ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe mbrojtëseve të të dëmtuarave A.H dhe F.G., duke vërtetuar dhe lenë në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për të mitur, PM.nr.294/2017 të 17 janarit 2019, me arsyetimin se gjykata e shkallës e parë në mënyrë të drejtë dhe korrekte e ka zbatuar ligjin penal dhe procedural.
20. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës, ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR.nr.235/2019 të 19 qershorit 2019, ushtron kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të pretendimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit procedural, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes se të drejtës për gjykim të drejtë që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së.
21. Më 1 nëntor 2019, Prokurori i Shtetit, i propozoi Gjykatës Supreme që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar dhe që aktgjykimet e instancave me të ulëta të vërtetohen.

22. Më 10 dhjetor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit PML.nr.319/2019, refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke e lenë kështu në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.235/2019 të 19 qershorit 2019, me të cilin ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për të mitur, PM.nr.294/2017 i 17 janarit 2019. Pjesë relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme: *“Se prekjet e të dënuarit ishin për qëllime seksuale, gjykata këtë fakt përveç që e vërtetoi me deklaratat e të dëmtuarave të mitura F.G dhe A.H G., të cilat i kanë përshkruar në detaje veprimet e të dënuarit gjatë kontrollit të tyre, ky fakt është vërtetuar edhe me dëgjimin e gjinekologut B.K, i cili në shqyrtimin gjyqësor ka sqaruar se, bazuar në protokollin e QMF në Malishevë, sa i përket të dëmtuarës F.G, ka lexuar terapinë ku të njëjtës i dënuari i kishte përshkruar antibiotik, tretje fiziologjike, paracetamol dhe një sirup për rrugët e frymarrjes. Edhe për të dëmtuarën A.H është shkruar terapia për dhimbje në lukth nga i cili protokoll i terapisë i QMF në Malishevë, rezulton se terapia e cila i është shkruar të dëmtuarave të mitura nga ana e të dënuarit, fare nuk ka pas të bëjë me kontrollin që i dënuari ia kishte bërë të miturave”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [PML.nr.319/2019], lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PAKR.nr.235/2019] dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për të mitur [PM.nr.294/2017], shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së.

i. Pretendimet për shkelje të nenit 22 të Kushtetutës

24. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me këtë pretendim thekson: *“Në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë zbatimi Konventës Evropiane Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj. Në nenin 6 par. 3 pika d) e kësaj konvente është parapare e drejta e të pandehurit për të ftuar dhe marr në pyetje dëshmitarë në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitaret e aktakuzës. Mirëpo një e drejtë e tillë i është mohuar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, që të ftohet dëshmitari ekspert i mjekësisë familjare, i cili do të shpjegonte me kompetencë të drejtat dhe obligimet e punës të mjekut specialist të mjekësisë familjare. Po ashtu u është mohuar edhe leximi i provave të shkruara nga Ministria e Mjekësisë. (shëndetësisë) Te kontrollohet edhe pse ato janë dokumente zyrtare. Kështu gjykatat kanë bërë shkeljen e cekur nga neni 22 të kushtetutës se Republikës se Kosovës”.*

ii. Pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës

25. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me këtë pretendim shton: *“...çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. Në këtë frymë, të kushtetutës është edhe neni 9 i Kodit të Procedurës Penale, ku parashihet barazia e palëve. Mirëpo, kjo praktikë në rastin konkret nuk është respektuar, për arsytet e cekura me lartë. Në vend që gjykata me qëllim të vërtetimit të*

drejte të drejtave dhe obligimeve të mjekut specialist të mjekësisë familjare, duke dëgjuar ndonjë ekspert të mjekësisë familjare dhe të lexohen prova të nxjerra nga institucionet shtetërore, dëgjon ekspert jo kompetent gjinekolog të cilët në shumë pyetje kanë deklaruar se nuk janë kompetent për të dhënë mendimin, sepse nuk janë ekspert të mjekësisë familjare dhe dëshmitarë që fare nuk kanë qenë prezent me rastin e kontrollës së të dëmtuarave”.

26. Për me tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se është viktime e një procedure penale të zhvilluar në mënyrë jo profesionale nga ana e prokurorisë dhe gjykatës, duke shtuar se të dy kontrollet e bëra nga ai janë në: *“perputhje me autorizimet e tij si specialist i mjekësisë familjare, e që gjatë procedurës i ka shpjeguar në mënyrë të qartë”.*

iii. Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

27. Përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës përmend se: *“Ne nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është paraparë e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në paragrafin 1 është paraparë se çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. Ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni është paraparë e drejta e të akuzuarit për paraqitjen e dëshmitareve dhe eksperteve dhe personave tjerë të cilët mund ti sqarojnë faktet. Mirëpo gjykata të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij nuk i është dhënë një mundësi e tillë, duke refuzuar propozimin e mbrojtjes për tu dëgjuar eksperti i mjekësisë familjare. Në këtë mënyrë gjykata nuk është paraqitur e paanshme . Përkundrazi është paraqitur e një anshme e që ka ndikuar që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij..., ti drejtohen me shkrim kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, me kërkesë për përjashtimin e kryetares së trupit gjykues”.*
28. Në fund parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës: të aprovojë kërkesës e tij; të caktojë një ekspert të mjekësisë familjare, i cili do të shpjegonte kompetencat dhe obligimet e specialistit të mjekësisë familjare; të miratojë masën e përkohshme, *“që të shtyjë ekzekutimin e dënimit me burg”* ndaj parashtruesit të kërkesës; dhe që Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML.nr.319/2019 të 10 dhjetorit 2019, atë të Gjykatës së Apelit, PAKR.nr.235/2019 të 19 qershorit 2019, dhe atë të Gjykatës Themelore në Prishtinë PM.nr.294/2019 të 17 janarit 2019, t'i shpallë nul dhe lënda t'i kthehet në rigjykim Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për të mitur.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

31. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtguesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtguesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtguesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtguesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...].”

32. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të mësipërme, Gjykata konstaton se parashtguesi i kërkesës është palë e autorizuar; i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; e ka qartësuar aktin e autoritetit publik kushtetutshmërinë e të cilit e konteston, konkretisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML.nr.137/2020, të 10 dhjetorit 2020; i ka specifikuar të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar; si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.
33. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtguesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht të nënrregullin (2) që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

34. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesë pretendon se me vendimet e kontestuarra të gjykatave të rregullta (siç janë përmendur në paragrafin 2 të këtij dokumenti) atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 22, 24 dhe 31 të Kushtetutës, dhe me nenin 6 të KEDNj-së.
35. Nga pretendimet e sipërcekura, Gjykata verën se esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në të vërtetë ka të bëjë me “gjykimin e drejtë dhe të paanshëm” që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së, sepse pretendimet si të tilla ndërliken me mënyrën e administrimit të provave, respektivisht me mohimin e të drejtës për të dëgjuar dëshmitarë-ekspertë të lëmisë mjekësore. Për me tepër, parashtruesi i kërkesë pretendon se është diskriminuar dhe shton: “...çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”.

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

36. Në këtë kontekst dhe në vijim, Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, sipas të cilit gjykatat janë të detyruara të interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNj).
37. Përkitazi me këtë, Gjykata rikujton përmbajtjen e paragrafëve 1, 2 dhe 4 të nenit 31 të Kushtetutës dhe të paragrafit 1 dhe 3 (d) të nenit 6 të KEDNj-së, që përcaktojnë:

Neni 31 i Kushtetutës

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

[...]

Neni 6 i KEDNj-së

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë...për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij.

[...]

3. Çdo i akuzuar ka të drejtë pikërisht që:

[...]

d. të marrë në pyetje, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të fitojë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitareve që e shfaqësojnë, në kushte të njëjta me dëshmitaret e akuzës;

38. Gjykata, duke iu referuar pretendimeve të parashtresit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në vazhdim do citojë pjesë relevante të vendimeve të gjykatave të rregullta, përkitazi me pretendimin se gjykatat e rregullta nuk morën për bazë kërkesën e tij për të dëgjuar si ekspert një specialist të mjekësisë familjare, për të përshkruar përgjegjësitë e specialistit të mjekësisë familjare.
39. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht i referohet Aktgjykimit PM.nr.294/2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 17 janarit 2019, ku në lidhje me këtë pretendim kjo instancë gjyqësore, arsyetoi:

“Trupi gjykues ka vlerësuar edhe propozimin e mbrojtëses se të akuzuarit Ramadan Sopaj qe të dëgjohet eksperti i mjekësisë familjare por gjykata e hodhi poshtë si të pabazuar për faktin se në këtë çështje penale ka mjaft prova qe vërtetojnë gjendjen faktike, e posaçërisht deklarata e të dëmtuarave që qartë kanë deklaruar se cilat ishin ankesat e sëmundjes së tyre dhe se dëgjimi i këtij eksperti do të ishte e panevojshme dhe do ta prolongojë procedurën dhe sepse duke u nisur nga parimi se ligji ka paraparë se lëndët për të mitur janë lëndë të natyrës urgjente që duhet të reagohej shpejtë në zgjidhjen e tyre me qellim qe të ndikohet pozitivisht në përmirësimin e të miturit, e duke pasur parasysh nenin 6 të Konventës Evropiane ku ceket koha e arsyeshme për një gjykim të drejtë, ... Bazuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve përkatësisht në nenin 40 (2) (b) (iii) ku ceket se çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal, apo i dëmtuar duhet të ketë të paktën garancitë qe vijojnë: se çështja e tij duhet të shqyrtohet pa vonesë. Kjo gjykatë në bazë të theksuarave më lartë ka vlerësuar se dëgjimi i ekspertit të Mjekësisë familjare pra nuk do të ishte e nevojshme ashtu qe hudhi poshtë edhe propozimin e mbrojtëses se Gjykata e Apelit ka propozuar qe të dëgjohet ky ekspert, nga se nuk kemi pas një propozim të tillë. Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e mbrojtëses së të akuzuarit që të administrohet si provë moduli - doracaku i menaxhimit të integruar për fëmijët e sëmurë e muajit shtator të vitit 2000 nga Organizata botërore e shëndetësisë pastaj Moduli i Ministrisë se shëndetësisë Qendra për

zhvillimin e mjekësisë familjare, botuar ne vitin 2007, por gjykata e hudhi si të pabazuar sepse nuk ishte kontestuese se i akuzuari kishte të drejtë të jep terapi sipas ankesave të dëmtuarave.”

40. Gjkata, tutje verën se pretendimeve të përsëritura të parashtruesit të kërkesës, për të dëgjuar si ekspert një specialist të mjekësisë familjare, i është përgjigjur po ashtu Gjkata e Apelit, e sidomos Gjkata Supreme, duke arsyetuar:

“Se prekjet e të dënuarit ishin për qëllime seksuale, gjykata këtë fakt përveç qe e vërtetoi me deklaratat e të dëmtuarave të mitura F.G dhe A.H, të cilat i kanë përshkruar në detaje veprimet e të dënuarit gjatë kontrollit të tyre, ky fakt është vërtetuar edhe me dëgjimin e gjinekologut B.K, i cili në shqyrtimin gjyqësor ka sqaruar se, bazuar në protokollin e QMF në Malishevë, sa i përket të dëmtuarës F.G, ka lexuar terapinë ku të njëjtës i dënuari i kishte përshkruar antibiotik, tretje fiziologjike, paracetamol dhe një sirup për rrugët e frymarrjes. Edhe për të dëmtuarën A.H është shkruar terapia për dhimbje në lukth nga i cili protokoll i terapisë i QMF në Malishevë, rezulton se terapia e cila i është shkruar të dëmtuarave të mitura nga ana e të dënuarit, fare nuk ka pas të bëjë me kontrollin që i dënuari ia kishte bërë të miturave.”

41. Nga sa me lartë, Gjkata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës mori përgjigje të arsyetuara nga të gjitha instancat gjyqësore, ku sipas arsyetimit të tyre vendimmarrja për shpalljen fajtor të tij, nuk bazohej vetëm në deklaratimet e ekspertit (gjinekologut), por edhe në deklaratat e vetë të dëmtuarave A.H. dhe F.G. si dhe pjesërisht nga deklaratat e katër dëshmitareve të tjerë.
42. Në këtë kuptim, Gjkata, rikujton se Gjkata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Ajo nuk ka as juridiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI68/17, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 50).
43. Gjkata vë theksin në qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjkata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjkata rithekson më tej se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Në të vërtetë është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI68/17, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 51 dhe 52, rastin KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29).

44. Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese, mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë ose jo arbitrar (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI68/17, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 54, dhe KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 30).

45. Për më tepër, Gjykata thekson se, në rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë, si në rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme, e cila vërteton vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilën parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor, por vetëm ka vërtetuar ligjshmërinë e tyre, duke qenë se, sipas Gjykatës Supreme, nuk kishte shkelje esenciale të dispozitave të ligjit penal dhe procedural (shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI122/19, parashtrues: *F.M.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 9 korrikut 2020, paragrafi 100, dhe KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shkurtit 2020, paragrafi 106).

46. Gjykata po ashtu thekson se në refuzimin e një ankese, apo siç është rasti konkret, në refuzimin e një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme, në parim, thjesht mund të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatave më të ulëta, në këtë rast Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore (shih rastet e GJEDNj-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Helle kundër Finlandës*, kërkesa nr. 20772/92, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, paragrafët 59-60).

47. Andaj, Gjykata vëren se arsyetimi i gjykatave të rregullta, duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të tij është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI68/17, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, paragrafi 55, dhe KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 32).

48. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo përmendja e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, Aktvendimin për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, KI136/14, paragrafi 33).

49. Prandaj, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojnë se me vendimin e kontestuar i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të

KEDNj-së. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

Pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës

50. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës, pretendon se me vendimet e kontestuara atij i është shkelur e drejta për “barazi para ligjit”, e cila garantohet me nenin 24 të Kushtetutës, duke shtuar se *“çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”*

51. Në lidhje me këtë, Gjykata merr parasysh dispozitat e nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

[...].”

52. Gjykata po ashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore, e cila vë në pah se vetëm dallimet në trajtim, të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, ose status, mund të paraqesin trajtim të pabarabartë brenda kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës. Për më tepër, në mënyrë që një çështje të ngrihet në bazë të nenit 24, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata analoge apo situata të ngjashme (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI157/18, parashtrues Gjykata Supreme e Kosovës, Aktgjykim i 13 marsit 2019, paragrafi 33, shih po ashtu rastet e GJEDNj-së *Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 56; dhe *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 16 marsit 2010, paragrafi 61).

53. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon se sipas cilës karakteristikë të identifikueshme, ose status, ai ishte diskriminuar në procedurat para gjykatave të rregullta. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se nuk është e mjaftueshme që parashtruesit t'i referohen në përgjithësi një trajtimi të pabarabartë për të vërtetuar diskriminimin, pa treguar bazën e kësaj pabarazie.

54. Andaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe vërtetuar shkeljen e të drejtave të tij në bazë të diskriminimit, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës. Prandaj, pretendimet e tij për shkelje të së drejtës për barazi para ligjit janë qartazi të pabazuara.

Kërkesa për masë të përkohshme

55. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht *“të shtyjë ekzekutimin e dënimit me burg të [tij], sepse në këtë mënyrë do të evitohet një dëm[...] i pa riparueshëm, për të gjykuarin, për shkak se në veprimet e tij nuk manifestohen elementet e veprës penale”*.
56. Gjykata sapo konkludoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbush kriteret procedurale të pranueshmërisë.
57. Prandaj, në pajtim me nenin 27, paragrafin 1 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 57 paragrafin (1) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit, përderisa kërkesa deklarohet e papranueshme.

Përfundim

58. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNj-së, si dhe të drejtën për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, gjatë procedurës me të cilën ai është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale, nga neni 232, paragrafi 3, pika 10, në lidhje me paragrafin 1 të KPRK-së.
59. Gjykata gjithashtu refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme, sepse e njëjta nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit, përderisa kërkesa deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 27.1 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2), 57 (4) (a), si dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 3 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË, kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi